



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ prot.

Lezhe, më ____ . ____ .2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERIALE PASTRIMI DHE DEZINFEKTIMI”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39831200-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,546,090 (pese milion e peseqind e dyzet e gjashte mije e nentedhjte) Lek pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kerkohet nje operator ekonomik i cili te kete minimumin e kerkuar duke marre ne konsiderate objektin e kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e maturuara te taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë një mjet transporti me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton.

- Për të provuar disponimin e mjetit të kërkuar, OE duhet të paraqesë:

a- Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksa, pronësia).

b- Për të konfirmuar disponibilitetin e mjetit të marre me qira ose kontrate bashkepunimi të paraqiten si më poshtë:

- Kontrate notoriale qiraje/ Kontrate Bashkepunimi, me afate të përcaktuara të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e kontratës.
- Kontrate notoriale qiraje/ ose kontrate bashkepunimi, të jete e shoqëruar me leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksa, pronësia).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport Analize nga organ i licensuar dhe Skemat Teknike për produktet e mëposhteme

Nr.	Emertimi
1	Detergjent rrobash (3kg)
2	Detergjent pllakash
3	ACE 1 litershe

4	Ilac xhamash 1 litersh
5	Sapun tualeti i lëngshëm (500 ml)
6	Zbutës rrobash
7	Acid per tualet 1 litersh

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për artikujt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi
1	Detergjent rrobash (3kg)
2	Detergjent pllakash
3	ACE 1 litershe
4	Ilac xhamash 1 litersh
5	Sapun tualeti i lëngshëm (500 ml)
6	Zbutës rrobash
7	Acid per tualet 1 litersh

Në plotësim të kësaj kërkesë dokumenti “Ofertë Teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese.	Emërtimi i katalogut ose skedës teknike	Shënime (nëse gjykohet e nevojshme për sqarime nga ofertuesi)
-----	-----------------------	-------------------------------	---	---

Argumentimi: 2.3.3, 2.3.4; Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Sa me sipër shfaqet e nevojshme që për mallrat objekt prokurimi, të paraqiten Raport Analize nga organ i licensuar dhe Skedat Teknike, si dhe oferta teknike, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit me specifikimet teknike.

Ne lidhje me këto kritere NJ.P. gjykon se janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e

rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me artikullin e kërkuar.

Akoma më tej NJ.P. gjykon se dokumentat e kërkuar raport analizat dhe skedat teknike mund të sigurohen lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me kete kategori produktesh për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre dhe te dhenat teknike per keto produkte. Po ashtu me këte kriter te vendosur, autoriteti kontraktor nuk ka tejkualuar objektin e prokurimit pasi për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall”, sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike.

Autoriteti Kontraktor ka perzgjedhur qe te paraqiten skedat teknike dhe raport analizat nje liste mallrash qe jane te lidhur ngushtesisht me perdorimin nga punonjesit ku te cilat mund te shkaktojne demtime ne shendetin e punonjesve apo perdoruesve te ketyre mallrave. Per rrjedhoje per keto mallra duhet te paraqiten skeda teknike dhe raport analiza nga organe te pavarura te licensuara per kryerjen e ketyre raport analizave.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor sipas kërkesave te ketij te fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues te paraqese çertifikatat perkatese te vlefshme si me poshte:

- ISO 9001:2015, mbi “Per Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë’ ose ekuivalentin e saj
- ISO 14001:2015, mbi “Per Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalentin e e saj.

Shënim: Certifikatat ISO duhet të jenë të lëshuara nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata, ISO në përputhje me % e bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Referuar natyrës se veçantë, te objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë dhe mjedisit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të

pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.7 Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emertimi
1	Detergjent rrobash (3kg)
2	Detergjent pllakash
3	ACE 1 litershe
4	Ilac xhamash 1 litersh
5	Sapun tualeti i lëngshëm (500 ml)
6	Zbutës rrobash
7	Acid per tualet 1 litersh

- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë magazines se Drejtorise se Sherbimeve Publike, se Bashkise Lezhe me adrese: Rruga “Vellezerit Coku”, Ish SMT, Lezhe.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specififikimet teknike te kerkuara.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”

Autoriteti Kontraktor ka perzgjedhur qe te paraqiten mostrat per nje liste mallrash qe jane te lidhur ngushtesisht me perdorimin nga punonjesit ku te cilat mund te shkaktojne demtime ne shendetin e punonjesve apo perdoruesve te ketyre mallrave. Per rrjedhoje duke qene se keto mallra ndikojne

drejtpersdrejti ne shendetin e punonjesve eshte kerkuar qe per keto mallra te paraqiten mostra me qellim krahasimin me specifikimet teknike.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese thekson se ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne hartimin/konfirmimin e specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: